


Miti i çmagjepsjes: Magjia, moderniteti dhe lindja e shkencave humane

Description

Jason Josephson- Storm

Konspekt librit: Jason Ananda Josephson Storm, *The Myth of Disenchantment: Magic, Modernity, and the Birth of Human Sciences* (University of Chicago Press 2017).



Max Weber ka qenë një nga artikulusit më të shkelqyer të të ashquajturës teza e shekullarizmit e cila është një paradigmë dominante në shkencat humane. Weberi argumentonte se periudha moderne post-industriale është fryt i një procesi të dyfishtë çmagjepsjeje. E para është rezultat i feve monoteiste

të cilat duke ia atribuuar gjithcka një Zoti të vetëm (pavarësisht dallimeve rreth kuptimit të kësaj hyjnie unike) e kanë zhveshur universin (krijimin) nga perëndi të ndryshme, gjysmëzota dhe shpirtra. Faza e dytë e çmagjepsjes ka ndodhur si rezultat i racionalizmit evropian i cili kulminoi në revolucionin shkencor. Sipas Weber-it në fazën e tij të fundit procesi i çmagjepsjes përbëhet nga dy aspekte 1) shekullarizimi dhe rënia e magjisë 2) rritja e shkallës dhe fuqisë të shkencës, ligjit, burokracisë dhe shtetit modern. Me pak fjalë moderniteti karakterizohet nga një proces çmagjepsjeje ku Zoti apo entite të tjera okulte janë hequr nga skena për tu zëvendësuar me racionalitetin dhe shkencën moderne.

Teza e shekullarizimit ka qenë dominante në shkencat humane, dhe jo vetëm, që nga fillimi i artikullit të saj. Ajo është në bazë të mitit modern të progresit dhe bindjes se tipari përcaktues i modernitetit është se njerëzit nuk besojnë më në shpirtra, mite apo magji. Thënë shkurt, njerëzimi jeton në një botë të çmagjepsur. Megjithatë, kohët e fundit një tezë e tillë ka qenë objekt i kritikave të ndryshme. Libri i Jason A. Josephson-Storm "Miti i çmagjepsjes: Magjia, moderniteti dhe lindja e shkencave humane" është një nga kritikave të fundit dhe më të mprehta të tezës së shekullarizimit. Jason. Josephson-Storm argumenton se kjo narrativë është e gabuar, pasi përpjekjet për të shtypur magjinë ose elementët metafizikë kanë dështuar më shpesh sesa kanë pasur sukses. Në realitet shkencat humane kanë qenë më të magjepsura nga sa supozohet zakonisht. Në këtë vepër autori gjurmon historinë e mitit të çmagjepsjes që nga agji i disiplinave moderne të antropologjisë, sociologjisë, folklorit, psikanalizës dhe studimeve fetare. Autori argumenton se ironikisht, miti i modernitetit të çmagjepsur u formua në kohën kur Britania, Franca dhe Gjermania ishin në mes të ringjalljeve okulte dhe spiritualiste.

Në të vërtetë, argumenton Josephson-Storm, figurat themeluese të këtyre disiplinave të shkencave humane nuk ishin vetëm të vetëdijshme, por të përfshira thellësisht në mjedisin okult; dhe ishte veçanërisht në përgjigje të kësaj kulture në rritje ndaj shpirtrave dhe magjisë që ata prodhuan nocione të një bote të çmagjepsur. Autori ofron një biografi të themeluesve të disiplinave moderne humane si Max Müller, J. G. Frazer, Sigmund Freud, Walter Benjamin, Rudolf Carnap, etj. ku tregon përfshirjen e tyre në botën okulte dhe artikullimet e tyre të një bote të magjepsur. Autori përpjeket që jo vetëm të tregoj praninë e magjikes në jetën e këtyre personazheve por edhe rendësinë që elementët e magjishëm kanë në diskursin e tyre shkencor. Ndryshe nga ç'parashikonte teza e shekullarizimit, e ashtuquajtura vdekje e Zotit rezultoi si në një univers të pushtuar nga shpirtrat, por edhe në kthimin e perëndive dhe demonëve, pra në një rikthim të paganizmit, qoftë kjo në formë e spiritizmit, sinkretizmit teosofik apo rrymave New Age.

Si ilustrim konkret i asaj që autori ka ndërmend në analizën e tij po sjellim këtë pasazh nga fillimi i kapitullit të parë të librit:

Paris, 1907. Marie Curie u ul në dhomat luksoze të një apartamenti në Bulevardin Saint-Germain. Ndërsa dritat ishin të fikura, kimistja bashkoi duart me burrin që ishte ulur pranë saj, dhe së bashku ata panë që mediumi psikik përballë tryezës filloi të dridhej dhe të murmuriste, duke folur me një zë të çuditshëm të ulët, të kapërcyer nga forca e një shpirti posedues të quajtur "John King." Eusapia Palladino, siç quhej psikikja, besoj se ishte në gjendje t'i bënte objektet të lëviznin pa i prekur ato dhe të prodhonte "vizione të dritave ose pikave ndriçuese, vizione të duarve ose gjymtyrëve, ndonjëherë në formën e hijeve të zeza, ndonjëherë si fosforeshente." ¹ Në të vërtetë, siç treguan Curie dhe të tjerët më vonë, pikërisht në atë seancë, pikat ndriçuese filluan të shfaqen në errësirë, sikur të

kurorëzonin kokën e Eusapia -s në një aureolë vezulluese. Ngadalë, spiritistja shtriu duart e saj dhe i kaloi nëpër flokët e Marie Curie, duke përçuar tek ajo një ndriçim të vezullues. Dukej se prania e fuqive të padukshme ishte konfirmuar.²

Normalisht, Marie Curie nuk duhej të ishte e pranishme në këtë séance spiritiste. Ajo ishte në shumë aspekte një shembull i themeleve shkencore të asaj periudhe, një mendimtare kokëfortë dhe kritike që kishte bërë një numër zbulimesh mahnitëse. Gruaja e parë që fitoi një Çmim Nobel, ajo është një nga shumë pak njerëz në histori që e ka fituar atë dy herë (fizikë dhe kimi). Prania e Curie në një seancë spiritiste është një problem sepse shumë teoricienë kanë argumentuar se një nga gjërat që e bën botën moderne është refuzimi i animizmit, d.m.th. se në thelb, ne kemi eliminuar fantazmat, demonët dhe shpirtrat nga botëkuptimi bashkëkohor.³ Ndërsa historianët e spiritualizmit thonë tjetër histori, besohet gjerësisht se modernizuesit si Curie nuk kishin lidhje me idetë e forcave të padukshme. Prandaj, shumica e studiuesve do të habiteshin kur të mësonin se ajo po ndillte fantazma ose studionte manifestime paranormale si pjesë e kërkimit të saj të fizikës. Ky libër do të trajtojë jo vetëm joshjen e spiritizmit, por edhe do të argumentoj se narrativa e modernitetit si despiritualizim është në vetvete një mit.

Është joshëse të imagjinohet se për shkak të faktit që ajo në ato kohë ishte bërë vejushë, Curie donte të besonte se shpirtrat e të vdekurve vazhdojnë edhe pas jetës. Në fund të fundit, burri i saj, Pierre, kishte vdekur në prill 1906 dhe ditaret e saj nga ajo periudhë shpesh shprehnin dëshirën e saj të thellë për të komunikuar me të.⁴ Por ky nuk ishte seanca e parë që Marie Curie kishte marrë pjesë, dhe me të vërtetë çifti Curie ishin angazhuar në kërkimet psikike së bashku edhe para vdekjes së bashkëshortit të saj.

Për tre vjet, duke filluar nga viti 1905, disa nga shkencëtarët më të famshëm të Francës ishin mbledhur në apartamente dhe laboratorë në Paris për të studiuar këtë mediume spiritiste italiane – Eusapia Palladino. Përveç Curie-s, të tjerë shpesh të pranishëm ishin fiziologu i njohur Jacques- Ars. ne d'Arsonval, psikiatri i shquar Gilbert Ballet, mjeku aristokrat Konti Arnaud de Gramont dhe tre fitues të ardhshëm të Çmimit Nobel- fizikani Jean Baptiste Perrin, fiziologu Charles Richet dhe filozofi Henri Bergson.⁵ Francezët nuk ishin të vetmit të interesuar për Eusapia-n; nga viti 1872 deri në vdekjen e saj në 1918, fuqitë e saj u testuan nga ekipet e studiuesve në Angli, Itali, Poloni, Gjermani, Rusi dhe Shtetet e Bashkuara.⁶ Studiuesit paranormalë që hetuan Eusapia nuk ishin ekscentrikë marginalë, por ajka e establishmentit akademik të periudhës.⁷ Megjithatë, këta studiues po eksploronin zona që shpesh u shënuan nga bashkëkohësit e tyre si okulte, nëse jo plotësisht magjike. ⁸ Ata nuk e bënë këtë si një trashëgimi të “bestytive” mesjetare, as në përgjithësi si një mënyrë për të përmbysur shkencën, por më tepër si një mjet për të zgjeruar kufijtë e asj.

Jo të gjithë ata që u takuan me Eusapia-n ishin një besimtar në fuqitë e përtejme; disa ishin të bindur se ajo ishte sharlatane, por të tjerë erdhën për të pranuar se diçka e jashtëzakonshme kishte ndodhur në ato dhoma të errësuar. Në Paris mund të gjesh spektrin e plotë – nga skeptikët deri tek besimtarët spiritistë e deri tek ata që preferuan të shpjegonin seancat në lidhje me format e energjisë të panjohura më parë. Bergson, për shembull, filloi me dyshime serioze, por përfundoi duke prodhuar një filozofi të

informuar paranormalisht dhe madje duke u bërë president i Shoqërisë Britanike për Kërkime Psikologjike në 1913.9 Kjo është ndoshta më pak e habitshme për një filozof si ai i famshëm për formulimin e elan vital, dhe për faktin se motra e tij Moina Mathers (ne Mina Bergson) ishte bashkëthemeluese e një prej organizatave magjike më të famshme të periudhës, Urdhrit Hermetik të Agimit të Artë (shih kapitullin 6). Por figura të tjera profesionet e të cilëve ishin më konvencionale shkencore u prekën gjithashtu nga përvojat e tyre me Eusapia-n.

Në një nga letrat e fundit para vdekjes së tij (drejtuar Louis Georges Gouy, 14 Prill 1906), Pierre Curie vërejt: “Ne kemi pasur edhe disa seanca të tjera me mediumen Eusapia Palladino (ne kishim tashmë seanca me të verën e kaluar). Rezultati është se këto fenomene ekzistojnë vërtet dhe nuk është më e mundur që unë të dyshoj në to. Është e pabesueshme por është kështu; dhe është e pamundur ta mohosh atë pas seancave, të cilat i kemi kryer në kushte të kontrolluara në mënyrë perfekte.” Ai shtoi: “Sipas mendimit tim, këtu ka një fushë të tërë të fakteve dhe gjendjesh fizike të hapësirës që janë krejtësisht të reja, ??për të cilat ne nuk kishim konceptim.” 10 Ndërsa Marisë i mungonte entuziazmi i burrit të saj, ajo vërejt në frëngjisht në një letër drejtuar një miku më 16 prill 1906, “Kohët e fundit morëm pjesë në disa seanca me Eusapia-n, disa prej të cilave janë dukur shumë bindëse. Është një çështje me interesin më të madh.” 11 Në një letër drejtuar një mikeshë polake, ajo ishte më pak e ruajtur, duke deklaruar: “Personalisht, unë jam mjaft e gatshme të pranoj ekzistencën e fuqive të pazakonta në medime të tilla si Eusapia ose Znj. Stanis?aëa [Tomczyk].” 12 Edhe psikologu William James – megjithëse nuk kishte qenë dëshmitar i drejtpërdrejtë i seancave të Eusapia-s pohoi: “Se dukuritë e saj me siguri janë të vërteta më duket e vërtetuar.” 13

Çështja këtu nuk është të tallja me William James dhe Curies për syleshësinë e tyre, e aq më pak të mbrojtja, bazuar mbi autoritetin e tyre, që medimet spiritiste me të vërtetë dikur shërbenin si kanale për të kontaktuar të vdekurit. Në të vërtetë, fokusi ynë kryesor nuk është të diskutojmë fizikën ose shpirtrat si të tillë, por më tepër të ofrojmë një histori kulturore dhe intelektuale të specialistëve të shkencave sociale dhe filozofëve. Duke vepruar kështu, unë sfidoj një nocion konvencional të modernitetit dhe sugjeroj që duhet të jemi më pak të befasuar sesa zakonisht për të gjetur shkencëtarë të të gjitha shtresave që bëjnë shoqëri me magjistarët. Arsyeja nuk eliminon “bestytinë”; mekanizmi shpesh prodhon vitalizëm; dhe se shpesh, në një dhomë të vetme, mund të gjejmë seanca spiritiste dhe shkencë. Narrativa e vetme më e njohur në historinë e shkencës është ajo e çmagjepsjes- e flakjes tutje të magjisë nga bota e drejtuar tani e tutje nga ligjet natyrore. Unë jam këtu për t’ju thënë se si një histori e gjerë kulturore, kjo narrativë është e gabuar. Përpjekjet për të shtypur magjinë kanë dështuar historikisht më shpesh sesa kanë pasur sukses. Është e paqartë për mua që shkenca deanimon domosdoshmërisht natyrën. Në në fakt, unë do të argumentoj à la Bruno Latour se ne kurrë nuk jemi çmagjepsur. Dhe për ata lexues që tashmë kanë dyshuar për qëndrueshmërinë e magjisë në modernitet, unë do të gjurmoj gjenealogjinë e mitit të çmagjepsjes dhe mënyrën se si ai u ndërtua për të funksionuar si një ideal rregullator.

Date Created
26/08/2021

Author
erasmusi